



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.11/2018  
Prishtinë, më 16.1.2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi, dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj dhe Qëndron Kastrati, anëtarë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Dardan Abazi, INDEP; Agnesa Haxhiu, KDI; Valon Rashiti, RTV-21; Albulena Mavraj, “Epoka e re”; Valbona Bytyçi, “Ekonomia online” dhe Sanie Jusufi, “Koha ditore”.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.12.2017;
- 3.Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-019 për Standardizim;
- 4.Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.17/21, datë 22.12.2017 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë;
- 5.Miratimi i Raportit vjetor të punës së komisionit për vitin 2017;
- 6.Miratimi i Planit të punës së komisionit për vitin 2018;
- 7.Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Mimoza Kusari –Lila**, propozoi që pika e katërt: “Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.17/21, datë 22.12.2017, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë”, të hiqet nga rendi i ditës, pasi që nuk e kanë marrë materialin.

**Kryetarja** sqaroi se vendimi i Qeverisë është proceduar në Kuvend, por ka mbetur për çështje administrative pa u shpërndarë.

*Rendi i ditës u miratua pa pikën e katërt: “Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.17/21, datë 22.12.2017, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë” .*

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 22.12.2017**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.12.2017, u miratuan pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-019 për Standardizim**

**Kryetarja**, sipas procedurës, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, komisionet e përhershme nuk kanë ndonjë amendament shtesë, por i kanë miratuar amendamentet e komisionit për Projektligjin nr. 06/L-019 për Standardizim, andaj kërkoi që të votohet raporti me rekomandime, në mënyrë që të shkojë në lexim të dytë, në Kuvend.

*Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

*Përfundim*

*1.Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 06/L-019 për Standardizim.*

*2.Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

## **4. Miratimi i Raportit vjetor të punës së komisionit për vitin 2017**

**Kryetarja**, tha se me qëllim të pasqyrit të punës së tij në vitin 2017 (tetor-dhjetor) të Legjislaturës VI, është hartuar ky raport, i cili përmban të dhëna, informacione dhe shënime, që tregojnë për aktivitetet dhe punët që i ka realizuar komisioni gjatë kësaj periudhe, në pajtim me detyrat dhe me përgjegjësitë që i ka të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ajo, pastaj, në mënyrë kronologjike e paraqiti Raportin vjetor të punës së komisionit për vitin 2017 për përdhën (tetor-dhjetor) si vijon: Komisioni gjatë këtij sesiioni ka zhvilluar aktivitetet e tij, në bazë të Planit të tij të punës, të hartuar gjithnjë duke u bazuar në Strategjinë legjislativë të Qeverisë. Këto aktivitete, komisioni i ka realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, mbledhjeve të grupeve të punës, monitorimit të zbatimit të ligjit, takimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit dhe nëpërmjet vizitave zyrtare në institucionet përkatëse, me qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre. Komisioni, gjatë sesiionit vjeshtor të Legjislaturës VI të këtij viti, i

ka realizuar gjithsej 10 (dhjetë) mbledhje të rregullta. Mbledhjen e tij të parë e ka mbajtur më 10.10.2017, që është aktiviteti i parë i tij për këtë sesion. Ndërkaq, mbledhja e fundit e komisionit është mbajtur më 22.12.2017, që është aktiviteti i fundit i komisionit për vitin 2017. Në mbledhjet e Komisionit, sipas ftesës, kanë marrë pjesë përfaqësues të ministrive (ministra etj.) dhe përfaqësues të organizatave të tjera. Mbledhjet e komisionit kanë qenë publike dhe janë monitoruar nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, vendore e ndërkombëtare. Po ashtu, puna e komisionit ka pasur hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe në ato elektronike. Vlen të ceket se komisioni ka hartuar “Projektligjin për Miniera dhe Minerale”. Duke i marrë parasysh aktivitetet e zhvilluara gjatë këtij sesioni, komisioni ka arritur në masën më të madhe të përmbush Planin e punës për këtë sesion. Dhe, ftoj komisionin që ta miratojë të njëjtin.

*Pas debatit, komisioni nxori:*

*Përfundim*

*Miratohet Raporti vjetor i punës së komisionit për vitin 2017.*

## **5. Miratimi i Planit të punës së komisionit për vitin 2018**

**Kryetarja**, tha se ky plan i punës është hartuar në bazë të programit legjislativ, të dërguar nga Qeveria në Kuvend dhe aktivitetet e mbetura nga viti i kaluar, si dhe propozime shtesë. Është vetëm draft, nëse jeni të pajtimit, ne mund ta diskutojmë dhe miratimin ta lëmë në ndonjë mbledhje tjetër. Në qoftë që ka dikush të shtojë diçka, le të propozojë. Pra, sot po e bëjmë një shqyrtim vetëm në parim dhe në mbledhjen radhës e miratojmë.

**Hykmete Bajrami**, propozoi që të kërkohet nga Ministra e Tregtisë dhe Industrisë, që Projektligji për masat mbrojtëse në importe, masat antidamping dhe tregti të brendshme, t’i sjellin në pako, pasi që janë të ndërlidhur në mes veti dhe ne si komision duhet t’i shqyrtojmë në pako. Kërkoj të ftohet ministri i Ministrisë së Zhvillimit Rural për raportim në komisioni dhe të na njoftojë për buxhetin që u është ndarë se si do t’i orientojë dhe menaxhojë, cilat janë planet e ministrisë?

**Mimoza Kusari-Lila**, propozoi që për planin e punës për vitin 2018, të ketë një konsultim më të gjerë në komision, në mënyrë që t’i specifikomë më shumë punët konkrete se si do t’i organizojmë vizitat në biznese dhe tryezat. Po ashtu, kërkoj që të ftohet ministri i Infrastrukturës, që të raportojë lidhur me penaltitë që janë parashtruar nga “Bechtel-Enka”, lidhur me ndërtimin e autostradës Prishtinë –Shkup.

**Memli Krasniqi**, kërkoj që për çështjet e hapura që janë në planin e punës për vitin 2018, te vizita e bizneseve, të përcaktohet sektori, cilat biznese do t’i vizitohet dhe tek organizimi i tryezave, të përcaktohet tema. Po ashtu, pajtohem që pas 6 muajve ta bëjmë një rishikim të planit të punës.

**Dardan Sejdiu**, tha se pajtohet me propozimin e deputetes Kusari – Lila, për ta ftuar ministrin e Infrastrukturës, si dhe ndoshta do të ishte mirë që të përgatisim plan të punës me afate më të

shkurtra, pasi që edhe Qeveria nuk po i sjell me kohë, në bazë të programit, ligjet. Besoj që do ishte më frytdhënëse edhe për komisionin, sepse do të kishim mundësi t'i trajtojmë më mirë temat. Po ashtu, theksoi se janë disa ligje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e prodhuesve vendorë, përsëri janë në plan të punës, sipas agjendës së Qeverisë janë të shpërndara nëpër muaj të ndryshme. Kjo mund të na shkaktojë telashe, sepse mund të kemi koherencë mes tyre dhe në zbatueshmëri në arritjen e qëllimit final. Propozoi që t'i dërgohet një shkresë Qeverisë, se këto projektligje që i ceku edhe deputetja Bajrami, t'i sjellin në pako, sepse si komision, mund ta trajtojmë më mirë temën e industrisë vendore, me ligjet përkatëse që na duhen për këtë industri.

**Bilall Sherifi**, tha se kërkoj të njoftohemi, së pari, a janë kërkuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, që të sillen në pako këto projektligje dhe a kemi marrë përgjigje?

**Kryetarja**, tha se kohën kur ka qenë ministri, z. Bajram Hasni, i është kërkuar që brenda mundësive t'i sjellin këto ligje në pako. Por, kërkoj edhe nga deputetët tjerë që të kthehen në rend dite, sepse po diskutohet për plan pune, ndërsa ministrat i ftojme sa herë ta shohim të arsyeshme, për tema të ndryshme.

**Gani Dreshaj**, tha se si komision, duhet të mundohemi të bëjmë ligje që qëndrojnë gjatë, pavarësisht ndërrimit të qeverive. Po ashtu, propozoi që të formohet një komision, që të mbikëqyrë të gjitha kontratat që janë lidhur me kompanitë e huaja, pasi që buxhetit të Kosovës i kanë kushtuar shumë dëme, siç është në rastin e penaltisë nga "Bechtel - Enka" për ndërtimin autostradës Prishtinë – Shkup, me shumën prej 63 milionë eurosh. Po ashtu, ceku çështjen e naftës që, si komision, duhet të merremi seriozisht.

**Dardan Sejdiu**, propozoi që në planin e punës të jetë edhe kërkesa e tij, që t'i sillen komisionit të gjitha kontratat shtetërore, duke filluar nga viti 2008, në mënyrë që ta kemi një mbikëqyrje, se çka ka ndodhur me këto kontrata. Ai, po ashtu, kërkoi që qysh javën e ardhshme të ftohet ministri i Ministrisë së Infrastrukturës, z. Pal Lekaj dhe që t'iu sjellë kontratën. Po ashtu, të kërkohet kontrata që kanë lidhur MZHE-ja me "Contour Global" për ndërtimin TC "Kosova e re", në mënyrë që të kemi qaseje edhe ne si komision, në kontratë.

**Mimoza Kusari-Lila**, tha se pajtohem që të ftohet ministri i Ministrisë së Infrastrukturës, z. Pal Leka, të na informojë për procesin se si kanë ardhur penaltitë nga kompania "Bechtel - Enka" për ndërtimin autostradës Prishtinë –Shkup. Po ashtu, para së të vijë për raportim, ministri i Infrastrukturës të na sjellë dokumentacionin, me kontratë.

**Hykmete Bajrami**, tha në kohën sa ka qenë ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka pasur vullnet që ta rregullojë sektorin e tregtisë së naftës, por kur Projektligji për tregtinë me naftë ka ardhur në Kuvend, kanë qenë deputet që nuk i kanë përkrahur propozimet e MTI-së, por kanë pranuar propozimet e Shoqatës së Naftëtarëve, në mënyrë që t'iu lihet hapësira për keqpërdorim në tregun e naftës.

**Kryetarja** propozoi që të formohet një grupe punues për hartimin e Planit të punës për vitin 2018 dhe ai grup, në mbledhjen e radhës, ta paraqesë në komision për shqyrtim dhe miratim, si dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, që deri më datë 19.1.2018, të dërgojnë te stafi propozimet e veta për këtë plan.

*Pas debatit, komisioni nxori këtë:*

*Konkluzion*

*Shtyhet për miratim për mbledhjen e radhës Plani i punës së komisionit për vitin 2018.*

*Po ashtu, komisioni nxori këtë:*

**V E N D I M**

- 1. Formohet grupi punues për hartimin e Planit të punës së Komisionit për vitin 2018.*
- 2. Grupi punues ka këtë përbërje: Sala Berisha – Shala, kryesuese, Hykmete Bajrami dhe Mimoza Kusari – Lila, anëtare.*

**6. Të ndryshme  
Çështjet vijuese**

**a) Njoftim rreth udhëtimit zyrtar të komisionit në Vjenë, Austri 18-20 dhjetor 2017**

**Kryetarja** informoi anëtarët e komisionit për udhëtimin zyrtar në Vjenë, Austri, 18-20 dhjetor 2017, lidhur me pjesëmarrjen në mbledhjen e Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë dhe në Forumin e parë parlamentar të Evropës Juglindore, me temë: “Eficienca e energjisë dhe klima”. Po ashtu, theksoi se raporti i vizitës iu është shpërndarë edhe anëtarëve të tjerë të komisionit. Në përbërje të delegacionit isha unë, Sala Berisha-Shala, kryetare e komisionit dhe znj. Hykmete Bajrami, anëtare e komisionit. Në këtë raport mund të gjeni të gjitha të dhënat e detajuara, duke përfshirë edhe qëllimin e plenumit, që është të adresojë sfidat e përbashkëta të energjisë dhe të mbështesë ndërtimin e një funksionimi të plotë të tregut energjetik pan-evropian, i cili shkon në dobi të qytetarëve. Kjo mbledhje e plenumit i dedikohet sfidave të sigurisë së furnizimit me energji.

*Njoftimi i kryetares u përkrah nga komisioni.*

**b) Bashkëpunimi i komisionit me palët e interesit**

**Hykmete Bajrami**, propozoi që të behët një praktikë, që pas hartimit të amendamenteve të komisionit, të njëjtat t’i përcillen odave ekonomike dhe palëve tjera të interesit, sepse ata po ftohen në dëgjime, vetëm për projektligj e nuk po kanë informata se çfarë po ndodh me ndryshime. Së paku duhet të ftohen për projektligjet që kanë impakt direkt në të bërit biznes.

*Propozimi i deputetes u përkrah nga komisioni.*

**Mbledhja përfundoi në orën 12:45.**

**E përgatiti:  
Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

-----  
**Sala Berisha – Shala**